

Komisioni i Disiplinës
VENDIM
Nr. 4

Nr. 88 Prot.

18 tetor 2024

Më datë 16 tetor 2024 u mbledh Komisioni i Disiplinës i Federatës Shqiptare të Basketbollit, në drejtimin e kryetarit, z. Klevis Kaso, me praninë e anëtarëve, z. Franko Bushati dhe z. Klaudio Ndoja, për trajtimin e problematikave të hasura në ndeshjet:

Superliga Meshkuj							
Dita I							
1	Apolonia	v	Besëlidhja	13.10.2024	Dielë	Apolonia	18:00
2	Vllaznia	v	Teuta	12.10.2024	Shtunë	Qazim Dervishi	18:00
Kampionati Kombëtar Femra							
Dita I							
2	KB Teuta	v	Vllaznia	11.10.2024	Premte	Ramazan Njala	18:00

Në relacionet e Vëzhguesve të ndeshjeve paraqiten problematika lidhur me organizimin nga ekipet pritëse.

Për sa mësipër, Komisioni i Disiplinës pasi trajtoi materialet përkatëse për shqyrtim, duke marrë në konsideratë relacionet e Vëzhguesve bazuar në nenin 16.8, të rregullores së aktiviteteve kombëtare të basketbollit,

Vendosi:

1. Sanksion financiar në vlerën 30'000 lek për shoqatën Apolonia Basket, si ekip organizator i ndeshjes, bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 13.8 pika ç, *“Hedhje e objekteve të rrezikshme në fushën e lojës, para, gjatë ose pas ndeshjes (pa u larguar ekipet dhe gjyqtarët), në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare”*.
2. Sanksion financiar në vlerën 10'000 lek për shoqatën Vllaznia Basket, si ekip organizator i ndeshjes, bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 13.8.b, *“Përdorimi i mjeteve tymuese që shkaktojnë ndërprerjen e përkohëshme të ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare”*.
3. Tërheqje vëmendje për shoqatën Akademia e Basketbollit Durrës, për ekipin KB Teuta si ekip organizator i ndeshjes, bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, duhet

të sigurojnë orarin e saktë për realizimin e ndeshjeve duke koordinuar me pallatin e sportit “Ramazan Njala”, duke shmangur vonesat për fillimin e ndeshjes.

Në bazë të rregullores së aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 11.8, “Kundër vendimit të komisionit të disiplinës, mund të apelohe brenda 72 orëve nga marrja e vendimit. Apeli duhet të adresohet pranë Komisionit të Apelit në FSHB dhe duhet të jetë i shoqëruar me vërtetimin e pagesës së shumës 10’000 në arkën e FSHB-së. Një kopje e kërkesës së apelit i dërgohet palëve. Komisioni i apelit trajton dhe shqyrton çdo vendim që është marrë nga komisioni i disiplinës dhe kontestohet nga palët e përfshira në vendim. Vendimet e Komisionit të Apelit mund të ankimohen në KAS, (Këshilli i Arbitrazhit Sportiv).”



Klevis Kaso
Kryetar



Franko Bushati
Anëtar



Klaudio Ndoja
Anëtar